



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.696/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci kryesues, Faton Ademi dhe Rustem Thaçi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Shkodran Pulaj kandidat për Kuvendin Komunal në Prizren nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prizren, paraqitur për shkak të parregullsive për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021, në seancën e panelit të mbajtur me datë 22.10.2021, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa Anr.696/2021 e datës 21.10.2021, e paraqitur nga Shkodran Pulaj kandidat për Kuvend Komunal në Prizren nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), paraqitur për shkak të parregullsive për Zgjedhjet Lokale të datës 17.10.2021.

A r s y e t i m

Me datën 21.10.2021 PZAP-i ka pranuar një ankesë të dërguar nëpërmjet Postës së Kosovës me datën 19.10.2021 nga Shkodran Pulaj kandidat për Kuvend Komunal në Prizren nga subjekti politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK), me seli në Prizren me të cilën pretendon se ka gjetur shkelje në Shkollën Filllore Heronjtë e Lumes në Prizren, në fshatin Shkozë me fletëvotim 2054-A, dhe në fshatin Zhur Komuna e Prizrenit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën gjeti se:

Ankesa është e pabazuar

Paneli, vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar asnjë provë apo dëshmi lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, paneli, nuk

mundi të konstatoj se ka pasur ndonjë parregullsi, për faktin se thëniet e tij nuk mbështetën në asnjë provë konkrete.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për apelet dhe ankesat nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë dhe nga mos ofrimi i asnjë prove apo dëshmie parashtruesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur ndonjë parregullsi, pasi që ankesa e parashtruesit ka qenë sipërfaqësore dhe jo e konkretizuar, dhe si të tillë të njëjtën e refuzoi si të pabazuar.

Paneli në kuptim të nenit 115.1 dhe nenit 117.3 lidhur me nenin 118 par.1 të LZP-së, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.696/2021 më datën 22.10.2021



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.